



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 74/2 Prot.

Tiranë, më 04 / 02 / 2022

VENDIM

Nr. 2 Datë 04 / 02 / 2022

PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT TË FAZËS SË DYTË TË PROJEKTEVE FITUESE TË BASHKËPUNIMIT TEKNIKO-SHKENCOR NDËRMJET SHQIPËRISË DHE AUSTRISË

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të Ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; të VKM Nr. 607, datë 31.08.2016, "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)", të Urdhërit nr.10, datë 15.01.2021, "Për ngritjen e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)", si dhe të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Shkencor e Teknologjik midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë nënshkruar më 02.05.2012, dhe Protokollit të Përbashkët të nënshkruar më 5.12.2014, Vendimit të Bordit të Administrimit Nr. 2, datë 30.05.2019, "Për miratimin e projekteve dypalëshe të bashkëpunimit tekniko shkencor ndërmjet Shqipërisë dhe Austrisë, Bordi i Administrimit të AKKSHI-së, në mbledhjen e datës 04 . 02 .2022,

VENDOSI:

1. Miratimin e financimit të fazës së dytë të projekteve dypalëshe, të bashkëpunimit tekniko shkencor ndërmjet Shqipërisë dhe Austrisë, miratuar si projekte fituese me Vendim të Bordit të Administrimit Nr. 2, datë 30.05.2019, sipas listës bashkëngjitur.
2. Ngarkohet AKKSHI për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Znj. Evis KUSHI, Kryetare

Evis Kushi

Z. Skënder TOPI, Anëtar;

Skender Topi

Znj. Zamira GJINI, Anëtare;

Zamira Gjini

Znj. Eva BICA, Anëtare;

Eva Bica

Z. Vasil S. TOLE, Anëtar;

Vasil S. Tole

Znj. Ines MUÇOSTEPA, Anëtare;

Ines Muçostepe

Projektet bilaterale Shqipëri-Austri (Thirrja 2-2019) Miratuar me Vendim të BA Nr. 2 datë 3-05/2019

Faza e dytë e financimit

Nr.	Titulli i projektit	Institucionet aplikuese Al/Austri	Drejtesit e projektit Al/Austri	Buxheti i kerkuar viti 2-te - mijë Leke
1	Krahasimi midis ophioliteve të Voskopojës dhe kompleksit të Kores Oqeanike të Pukës, KRABIT Shqipëri: Studim gjeokimik, petrologjik dhe strukturor).	Universiteti Politeknik i Tiranës, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit.	Kujtim Onuzi	500,000 ALL
2	Studimi gjeokimik, sedimentologjik dhe paleontologjik I sedimenteve të Permian-Triasikut (P-T) në Shqipëri dhe Austri: studime të ndryshimeve rajonale dhe bashkëvolimi gjatë një ndryshimi shumë të ndjeshëm të kushteve mjedisore globale	Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave	Cercis Durmishi	500,000 ALL
3	Zhvillimi Urban I Qëndrueshëm I periferive mes Graz dhe Tiranës: Shtrirja dhe dendësia	Universiteti Polis	Besnik Aliaj	500,000 ALL
4	Ripërdorimi i strukturave ekzistuese në Shqipëri dhe Austri	Universiteti Polis	Etleva Dobjani	500,000 ALL
5	Struktura gjenetike e çajit të malit (Sideritis raeseri, Lamiaceae): një specie e mbishfrytëzuar në resurset natyrore të Shqipërisë	Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	Alban Ibrahliu	322,000 ALL
6	Menaxhimi i integruar i burimeve ujore në Shqipëri në rrugën drejt Bashkimit Evropian	Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	Alma Imeri	497,500 ALL
7	Transferimi i dijes dhe Inovacioni Digjital ndërmjet Austrisë dhe Shqipërisë	Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë	Kozeta Sevrani	477,000 ALL
8	Vlerësimi i llojeve dhe diversiteti i komunitetit të molusqeve ujore të liqeneve karstike të Belshit në Shqipërinë Qendrore, duke përdorur taksonominë integruese	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës.	Sajmir Beqiraj	1,016,000 ALL
9	Monitorimi i ndotësve toksikë në ajrin e ambientit të Tiranës dhe Elbasanit, Shqipëri	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Alma Shehu	1,000,000 ALL
	TOTALI			5,312,500 ALL